

Nr. \_\_\_\_ Prot., më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_ Prot., më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

## KONTRATË PËR SHIT-BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Sot më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_, nënshkruhet kjo kontratë për shitblerjen e energjisë elektrike midis palëve:

**Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A.**, shoqëri aksionere, regjistruar në 30.03.2018 në Regjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81530029T, me seli Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati i IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori znj. Erina REXHEPI, në cilësinë e **“Blerësit ose FTL”**

dhe

**Shoqërisë “\_\_\_\_\_”**, shoqëri \_\_\_\_\_, regjistruar në \_\_\_\_\_ në Regjistrin Tregtar të mbajtur pranë \_\_\_\_\_ me NUIS \_\_\_\_\_, me seli \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, përfaqësuar nga \_\_\_\_\_, në cilësinë e **“Shitësit”**

### BAZA LIGJORE:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.3.2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar,
- Vendimi i Entit Rregullator të Energjisë Nr. 139, datë 15.08.2016 “Për Rregullat e Përkohshme të Tregut të Energjisë Elektrike”, i ndryshuar,
- Vendimi i Bordit të ERE Nr. 103, Date 23.06.2016 “Rregullore për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, i ndryshuar.

**Palët bien dakord të nëshkruajnë këtë kontratë sipas termave dhe kushteve të mëposhtme:**

## Neni 1

### Përkufizime

Për qëllimet e kësaj kontrate, fjalët dhe termat e mëposhtme do të kenë kuptimet e përcaktuara këtu. Sipas kontekstit të kontratës, përkufizimet mund përdoren në njëjës, shumës, në gjininë mashkullore apo femërore:

- 1.1 Përkufizimet** - termat e përdorur në kontratë do të kenë kuptimin e përcaktuar në ligjin Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimin e Bordit të ERE Nr. 103, datë 23.06.2016 “Rregullore për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” i ndryshuar, vendimin e Bordit të ERE Nr. 139, datë, 15.08.2016 “Rregullat e përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore.
- 1.2 Program** - do të thotë veprimet e nevojshme për një palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit ose pranimit, që mund të përfshijnë nominimin, programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me Palën tjetër, sasinë e kontratës, kapacitetin e kontratës, pikën e livrimit, programin e livrimit, periudhën totale të furnizimit dhe çdo kusht tjetër përkatës të kontratës sipas gjithë rregullave të zbatueshme të tregut të miratuara nga ERE, “FTL”-së dhe praktikave e procedurave të tjera të zakonshme industriale.
- 1.3 Referencat në kohë** - referencat në kohë do të jenë sipas Kohës Qendrore Evropiane (CET).
- 1.4 Rregullat e tregut** - janë rregulla të hollësishme, të cilat përcaktojnë mënyrën e operimit dhe menaxhimit të tregut, regjistrimin e pjesëmarrësve, përgjegjësinë e balancimit prej pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, si dhe çështje të tjera lidhur me funksionimin e tregut.
- 1.5 Pikë livrimi** - do të kuptohet zona e kontrollit të sistemit të transmetimit (AL-GR; AL-KS; AL-MN dhe brenda rrjetit shqiptar të transmetimit).
- 1.6 Forcë Madhore** – Është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.
- 1.7 Aneksi Nr. 1** – Aneks tip i programit të livrimit dhe shit-blerjes së energjisë elektrike për procedurën përkatëse.
- 1.8 Aneksi Nr. 2** – Aneks tip për sasinë dhe oraret e energjisë elektrike të nominuara nga palët në sistemin DAMAS të “OST” SH.A.

## Neni 2

### Objekti i kontratës

Kjo kontratë, përfshirë Aneksat e saj (pjesë integrale të saj), rregullon marrëdhëniet midis Palëve për secilën prej blerjeve, shitjeve, livrimeve dhe pranimeve të energjisë elektrike, që janë rezultat i

pjesëmarrjes së paleve në procedurat e blerjes së energjisë elektrike të zhvilluara nga Blerësi, përgjatë periudhës kohore që shtrihet nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate dhe deri në datë 31 Dhjetor 2021, me të drejtë rinovimi.

### **Neni 3**

#### **Procedura e nënshkrimit të kontratës dhe të Aneksit përkatës**

- 3.1** Kjo kontratë nënshkruhet vetëm një herë dhe shërben si parakusht për pjesëmarrje në procedurat e shitblerjes së energjisë elektrike që zhvillohet nga “FTL” SH.A.
- 3.2** Për çdo blerje që do të kryhet gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, për çdo procedurë në të cilën Shitësi do të shpallet fitues, do të nënshkruhet nga të dyja Palët vetëm Aneksi përkatës.
- 3.3** Të gjithë Anekset që do të nënshkruhen midis Palëve gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate përbëjnë pjesë integrale të saj.
- 3.4** Aneksi nuk do të ndryshojë kushtet e kësaj kontrate dhe do të hartohet sipas të gjitha përcaktimeve të bëra në të, në lidhje me objektin e shitjes, lëshimin e faturës, mënyrën dhe afatet e pagesës, etj.
- 3.5** Palët bien dakord që mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë kontratë dhe Anekset e saj përbën shkelje të kontratës dhe trajtohen sipas nenit 12 të saj.
- 3.6** Pas dërgimit të njoftimit të rezultateve të procedurës së prokurimit, Blerësi do të dërgojë me email në adresën elektronike të Shitësit Aneksin e plotësuar në përputhje me ofertën e pranuar.
- 3.7** Shitësi pas marrjes së Aneksit të plotësuar nga Blerësi, e dërgon atë brenda 1 dite pune, të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor ose personi i autorizuar, të skanuar me email në adresën elektronike të Blerësit [info.trading@ftl.al](mailto:info.trading@ftl.al). Brenda 3 (tre) ditëve pune nga dërgimi i emailit, origjinali i Aneksit në 4 (katër) ekzemplarë do të dorëzohet me postë ose dorazi në “FTL” SH.A.
- 3.8** Blerësi do t'i dorëzojë me postë ose dorazi Shitësit 1 (një) kopje të Aneksit të nënshkruar në mënyrë të ndërsjelltë brenda 2 (dy) ditëve të punës nga data e marrjes së tij.

### **Neni 4**

#### **Sasia dhe çmimi i kontraktuar**

- 4.1** Sasia, çmimi si dhe vlera e energjisë elektrike të kontraktuar që Shitësi duhet t'i livrojë Blerësit, do të specifikohet në Aneksin përkatës.
- 4.2** Anekset që do të nënshkruhen deri në 31 Dhjetor 2021 do të identifikohen me të dhënat/referencat e procedurës përkatëse të prokurimit.

### **Neni 5**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e shitësit**

- 5.1** Shitësi duhet të programojë, livrojë, krijojë kushtet për livrimin dhe të sigurojë energjinë elektrike në sasinë, programin dhe periudhën kohore në përputhje me Aneksin përkatës të kësaj kontrate dhe të përcaktuar në ofertën e dhënë në procedurën e blerjes së energjisë elektrike.
- 5.2** Shitësi do të sigurojë sasinë e energjisë elektrike në përputhje me rregullat e nominimit të përcaktuara në Rregullat e Përkohshme të Tregut të Energjisë.
- 5.3** Shitësi do të paguhet nga Blerësi për sasinë e livruar të energjisë elektrike sipas çmimit të

përcaktuar në Aneksin përkatës.

- 5.4** Për procedura shitblerje energjie elektrike me vlerë faturë përkatëse mbi 200.000 (dyqind mijë) Euro pa TVSH, Shitësi ka të drejtën të kërkojë nga Blerësi lëshimin e instrumentit të Premtim-Pagesës, instrument i cili do të lëshohet nga Blerësi dhe do të garantohet nga shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” SH.A.
- 5.5** Me kërkesë të Blerësit, Shitësi do t'i dërgojë Blerësit Premtim-Pagesën brenda 5 ditësh pune pasi të jetë paguar e gjithë shuma e Faturës.

## **Neni 6**

### **Të drejtat dhe detyrimet e blerësit**

- 6.1** Blerësi do të pranojë programet e paraqitura nga Shitësi, sipas sasisë dhe profilit të livrimit të përcaktuar në Aneksin përkatës, në zbatim të kësaj kontrate dhe në përputhje me rregullat e nominimit të përcaktuara në Rregullat e Përkohshme të Tregut të Energjisë.
- 6.2.** Në rast se Shitësi ushtron të drejtën e tij të përcaktuar në nenin 5.4. të kësaj kontrate, Blerësi ka detyrimin të lëshojë 1 (një) Premtim-Pagesë, në vlerën totale të kontratës (përfshirë TVSH-në, nëse e aplikueshme), në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm.
- 6.3.** Premtim-Pagesa do të lëshohet nga Blerësi brenda 3 (tri) ditësh pune pas paraqitjes së kërkesës së Shitësit me e-mail në adresën elektronike [info.trading@ftl.al](mailto:info.trading@ftl.al) për lëshimin e këtij instrumenti.

## **Neni 7**

### **Livrimi, transmetimi dhe risku**

- 7.1** Livrimi konsiderohet i përmbushur kur bëhet e disponueshme sasia e kontraktuar në kapacitetin e duhur në Pikën e Livrimit, sipas kësaj kontrate. Livrimi dhe pranimi i sasisë së kontraktuar, si dhe transferimi nga Shitësi tek Blerësi i të gjitha të drejtave të çliruara nga çdo pretendim, do të kryhet në Pikën e Livrimit. Çdo livrim i energjisë elektrike sipas kësaj kontrate, duhet të kryhet në formë transaksioni të programuar.
- 7.2** Energjia elektrike do të livrohet me rrymën, frekuencën dhe tensionin e zbatueshëm në pikën përkatëse të livrimit të përcaktuara në këtë kontratë/ Aneks, në përputhje me rregullat dhe kodet në fuqi.
- 7.3** Shitësi merr përsipër të gjithë risqet dhe përgjigjet për çdo kosto apo pagesë në lidhje me programimin, transmetimin dhe livrimin e sasisë e energjisë elektrike së kontratës deri në pikën/at e livrimit. Blerësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të vendosur ose shoqëruese të programimit, pranimit dhe transmetimit të sasisë së kontratës/ Aneks në dhe nga pikat e livrimit.

## **Neni 8**

### **Mos performanca për shkak të Forcës Madhore**

- 8.1** Përveçse kur specifikohet ndryshe, për qëllimet e kësaj kontratë me “Forcë Madhore” do të kuptohet një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore “Pala Pretenduese”, por pa u kufizuar edhe në:

- a) Defektin në komunikim ose në sistemet kompjuterikë të OST-vë përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimit; ose
- b) Pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimit ose neglizhencës prej saj në përmbushjen e detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.

**8.2** Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim sipas kësaj kontrate/Anekseve të saj do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në masën që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet sipas nenit 9 nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasi të e palivruara ose të pamarra.

**8.3** Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimit të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësimet të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.

**8.4** Në rastet dhe masën që Shitësi çlirohet nga detyrimi i livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimit dhe pagesës. Në rastet dhe në masën që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimit për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.

## Neni 9

### Dëmet për Livrimin/Pranimin e vonuar (Mos-Performanca)

#### 9.1 Rasti i mos-performancës nga ana e Shitësit

Shitësi që ka detyrimin për livrimin e energjisë elektrike nuk e livron tërësisht ose pjesërisht sasinë e energjisë të përcaktuar sipas kushteve të kësaj kontrate dhe Aneksit përkatës dhe kjo paaftësi nuk justifikohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mos-performanca e Blerësit, Shitësi do t'i paguajë Blerësit si kompensim për dëmet, një shumë të barabartë me:

- a) Në rastin kur Blerësi e siguron këtë energji nga tregu i parregulluar, Shitësi do t'i paguajë Blerësit si kompensim për dëmet, një shumë të barabartë me sasinë e moslivruar të energjisë elektrike shumëzuar me një vlerë të barabartë me diferencën ndërmjet çmimit të kontratës zëvendësuese dhe çmimit të kontratës objekt mosperformancë, në rastin kur kjo diferencë është pozitive.
- b) Në rastin kur Blerësi nuk e siguron këtë energji nga tregu i parregulluar, Shitësi do t'i paguajë Blerësit si kompensim për dëmet, sasinë e moslivruar të energjisë elektrike shumëzuar me një vlerë të barabartë me diferencën ndërmjet, çmimit mesatar të Bursës Hungareze (HUPX) x (shumëzim) një koeficient të barabartë me 1.5, për periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë në një orë specifike, siç publikohet në website-in e kësaj burse ([www.hupx.hu](http://www.hupx.hu)) dhe çmimit të përcaktuar në këtë kontratë, në rastin kur kjo diferencë është pozitive.

## **9.2 Rasti i mos-performancës nga ana e Blerësit**

Kur Blerësi dështon të pranojë tërësisht ose pjesërisht sasinë e energjisë sipas kushteve të kësaj kontrate dhe Aneksit përkatës dhe kjo paaftësi nuk justifikohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mos-performanca e Shitësit, Blerësi do t'i paguajë Shitësit si kompensim për dëmet, një shumë të barabartë me:

- sasinë e mospranuar të energjisë elektrike shumëzuar me një vlerë të barabartë me diferencën ndërmjet, çmimit të kontratës dhe çmimit mesatar të Bursës Hungareze (HUPX), për periudhën në të cilën duhet të ishte kryer livrimi i energjisë në një orë specifike, siç publikohet në website-in e kësaj burse ([www.hupx.hu](http://www.hupx.hu)), në rastin kur kjo diferencë është pozitive.

**9.3** Palët marrin përsipër se do të zbatojnë automatikisht çdo ndryshim të akteve ligjore, nënligjore, rregullatore, dhe do t'i reflektojnë në amendimet përkatëse të kësaj kontrate, nëse do të jetë e nevojshme.

**9.4** Shumat si kompensim për dëmet sipas këtij neni do të paguhën brenda 30 ditëve nga pranimi i faturës.

## **Neni 10**

### **Faturimi dhe pagesa**

**10.1** Blerësi, brenda 3 (tri) ditëve nga dita e fundit e periudhës kohore të livrimit sipas parashikimit të të njëjtit Aneks, duhet t'i dorëzojë Shitësit, me email, Aneksin Nr. 2. Në rast se ka kontestime, Shitësi mund t'i paraqesë Blerësit një ankim për Aneksin Nr. 2 lidhur me saktësinë e të dhënave, brenda 2 (dy) ditëve pune nga dita që "FTL" SH.A., i ka dorëzuar këtë Aneks. Nëse Blerësi e konsideron ankimin të justifikuar ligjërisht, do të reflektojë ndryshimet në Aneks. Në rast se ankimi konsiderohet i pajustificuar ligjërisht, Blerësi do të njoftojë Shitësin brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja e ankesës.

**10.2** Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit për livrimin e energjisë elektrike një faturë sipas formatit dhe standardeve që kërkon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasi të totale të energjisë elektrike të shitur prej tij në periudhën kohore të livrimit të miratuar në Aneksin përkatës të kësaj kontrate. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e fundit e livrimit të energjisë elektrike (ose kur kjo datë është pushim zyrtar, ditën pasardhëse të punës). Kur periudha kohore e shit blerjes të energjisë elektrike është më e gjatë se 1 muaj, faturimet do të kryhen pas çdo periudhë livrimi, me bazë mujore. Krahas faturës, Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit edhe setin e të gjithë dokumentacionit.

**10.3** Pagesa e faturës do të bëhet brenda 180 ditëve nga data e depozitimit të faturës dhe të setit të plotë të dokumentacionit në protokollin e Blerësit.

**10.4** Nëse Blerësi dështon në kryejën e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, penalteti për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonësës, do të llogaritet me 0,05% në ditë mbi shumën e detyrimit të faturës së papaguar.

## **Neni 11**

### **TVSH-ja dhe taksat**

**11.1** Të gjitha shumat e referuara në këtë kontratë përjashtojnë çdo vlerë të zbatueshme të taksës së

shtuar ("TVSH"). Nëse TVSH-ja është e pagueshme për çdo shumë të tillë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një shumë të barabartë me TVSH-në me tarifën e zbatueshme. Një shumë e barabartë me TVSH-në e pagueshme nga një Palë do të kërkohet për t'u paguar vetëm kur Pala tjetër të sigurojë një faturë të vlefshme TVSH-je lidhur me atë shumë.

**11.2** Shitësi do të paguajë ose sigurojë pagesën e gjithë taksave për sasinë e kontratës ose lidhur me të që del para transferimit të riskut dhe titullit në pikën e livrimit. Blerësi do të paguajë ose do të kryejë pagesën e gjithë taksave në sasinë e kontratës ose lidhur me të që dalin gjatë ose pas transferimit të riskut dhe titullit në pikën e livrimit (përveç taksës direkte ose indirekte që lidhet me shitjen e sasisë së kontratës dhe është përgjegjësi ligjore e Shitësit). Në rast se Shitësit i kërkohet me ligj të paguajë çdo taksë të përshtatshme për llogarinë e Blerësit, Blerësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë Shitësin për këtë taksë. Në rast se Blerësit i kërkohet me ligj të paguajë çdo taksë të përshtatshme për llogarinë e Shitësit, Blerësi mund të kërkojë nga shitësi ta zbrisë shumën e kësaj takse nga shumat që i detyrohet Shitësit sipas kontratës, në të kundërt Shitësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë Blerësin lidhur me këto taksa të pazbritura. Nëse ndonjë taksë e re bëhet e zbatueshme ose një taksë ekzistuese rritet lidhur me kontratën dhe Blerësi është në gjendje ta kalojë përmes një pale të tretë, Blerësi do të jetë përgjegjës për këtë taksë të re ose të rritur.

**11.3** Gjithë pagesat sipas kontratës do të bëhen pa mbajtje ose zbritje për llogari të çdo takse përveç kur kjo mbajtje ose zbritje kërkohet me ligj. Nëse një Pale i kërkohet të mbajë ose zbrisë taksën nga një pagesë që duhet të bëjë, atëherë ajo Palë ("Pala Pagueuse") do të njoftojë menjëherë Palën tjetër ("Pala Marrëse") për këtë kërkesë dhe do t'u paguajë autoriteteve të duhura gjithë shumat e mbajtura ose të zbritura prej saj. Nëse mund të lëshohet një faturë ose provë tjetër që evidenton pagesën tek autoritetet, Pala pagueuse do t'ia dorëzojë këtë provë (ose një kopje të certifikuar) Palës marrëse.

## Neni 12

### **Mos përmbushje e detyrimeve kontraktore, likuidimi i dëmeve dhe ndërprerja e kontratës**

Mos përmbushje e detyrimeve të kontratës do të konsiderohet të ketë ndodhur nëse:

#### **12.1** Blerësi:

- Dështon të pranojë tërësisht ose pjesërisht sasinë e energjisë sipas të gjitha kushteve të kësaj kontrate dhe Aneksit përkatës dhe kjo paaftësi nuk shfajësohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mos-performanca e Palës tjetër; ose
- Dështon më shumë se një herë në kryerjen e pagesës në mënyrën dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë; ose
- në rast të revokimit të përkohshëm ose të përhershëm, ndërprerjes apo përfundimit të afatit të licencës për tregtim të energjisë elektrike në përputhje me legjislacionin në sektorin e energjisë elektrike; ose
- falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

#### **12.2** Shitësi:

- Nuk i livron tërësisht ose pjesërisht sasinë e energjisë të përcaktuar sipas të gjitha kushteve të kësaj kontrate dhe Aneksit përkatës dhe kjo paaftësi nuk shfajësohet nga një ngjarje e

Forcës Madhore ose nga mos-performanca e Palës tjetër; ose

- b) në rast të revokimit të përkohshëm ose të përhershëm, ndërprerjes apo përfundimit të afatit të licencës (kur është e aplikueshme) për tregtim të energjisë elektrike në përputhje me legjislacionin në sektorin e energjisë elektrike; ose
- c) falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

**12.3** Pala pretenduese dërgon pa vonesë, një njoftim për mospërmbushje të detyrimit, Palës që e ka shkaktuar atë.

**12.4** Në rast të mospërmbushjes së detyrimit kontraktor sipas pikës 12.1 a), dhe 12.2 a) pala pretenduese ka të drejtën që të kërkojë kompensim për dëmin sipas Nenit 9 të kontratës.

**12.5** Në rast të mospërmbushjes së detyrimit kontraktor sipas pikës 12.1, b) pala mospërmbushëse do të paguajë ndaj palës tjetër shumën e kompensimit për dëmet sipas Nenit 10.3 të kontratës.

**12.6** Në rast të mospërmbushjes së detyrimit kontraktor sipas pikave 12.1, c) dhe d) si dhe 12.2 b) dhe c) pala pretenduese ka të drejtë të kërkojë ndërprerjen e kontratës dhe të Aneksit përkatës si dhe ka të drejtën që të kërkojë kompensim për dëmin në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil.

**12.7** Palët mund të përdorin procedurën e kompensimit për detyrimet e ndërsjellta që rrjedhin nga kjo kontratë.

### **Neni 13**

#### **Transferimi**

Shitësi nuk ka të drejtë të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës dhe anekseve, me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Blerësit.

### **Neni 14**

#### **Konfidencialiteti**

**14.1** Palët bien dakord të trajtojnë dhe të konsiderojnë si konfidenciale, duke mos e përhapur, bërë të ditur apo lejuar përhapjen tek të tretët të gjitha informacionet, komunikimet dhe dokumentet e shkëmbyera apo të marra në zbatim të kësaj Kontrate (“Informacioni Konfidencial”) dhe që kanë të bëjnë me:

- a) parashikimet dhe ekzistencën e kësaj Kontrate;
- b) negociatat e kësaj Kontrate;
- c) informacionet mbi aktivitetin tregtar të Palëve;
- d) akte, komunikime dhe dokumente të tjera, të cilat shprehimisht cilësohen si konfidenciale nga Palët.

**14.2** Përjashtimisht nga sa parashikohet më sipër, Palët mund të përhapin informacionin konfidencial vetëm në masën që:

- a) kërkohet nga ligji apo aktet nënligjore, me kusht që Pala të ketë marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar përhapjen e tij;
- b) iu përhapen dhe bëhen të ditur bashkëpunëtorëve, Operatorit të Rrjetit, konsulentëve ligjore dhe financiare, bankave ose institucioneve të tjera financiare, agjenci vlerësimi ose përfitues të caktuar, me kusht që personi që merr Informacionin Konfidencial, t’i kërkohet që të trajtojë



Informacionin Konfidencial si të rezervuar në favor të Palës me të njëjtat kushte në këtë kontratë.

- c) informacioni konfidencial përhapet dhe bëhet publik pa fajin e Palëve ose të të tretëve pa shkelur këtë Kontratë; ose është në sistem apo përfshihet ligjërisht në domeinin publik.

**14.3** Dispozitat e këtij neni do të zbatohen nga Palët edhe në rast përfundimi apo zgjidhjeje të Kontratës, për cilindo shkak.

## **Neni 15**

### **Përfaqësimi i palëve**

- 15.1** Palët angazhohen të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e kontratës.
- 15.2** Secila Palë do të caktojë në këtë kontratë personin që do të jetë përgjegjës, për interes të Palës respektive, për kryerjen e komunikimeve përkatëse dhe për përfaqësimin e saj në problematikat që lidhen me ekzekutimin e kësaj kontrate.
- 15.3** Çdo komunikim ndërmjet palëve, do të bëhet me postë elektronike dhe/ose me shkrim, në adresat e përcaktuara më poshtë.
- 15.4** Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e ndryshimit.
- 15.5** Personat përgjegjës për përfaqësimin e Palëve në këtë kontratë, sipas paragrafit të dytë të këtij neni, do të jenë përkatësisht:

#### **Për Shitësin:**

**Administrator i kontratës:** \_\_\_\_\_

Pozicioni: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Tel: \_\_\_\_\_

e-mail: \_\_\_\_\_

**Person kontakti:** \_\_\_\_\_

Pozicioni: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Tel: \_\_\_\_\_

e-mail: \_\_\_\_\_

**Person kontakti:** \_\_\_\_\_

Pozicioni: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Tel: \_\_\_\_\_

e-mail: \_\_\_\_\_

**Për Blerësin:**

**Administrator i kontratës:** Irakli QIRIAKO  
Pozicioni: Drejtor/ Departamenti i Tregimit të Energjisë  
Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, ndërtesa nr. 88, H. 1, kati 4, Nësia Administrative nr. 7, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 0692097303  
e-mail: [irakli.qiriako@ftl.al](mailto:irakli.qiriako@ftl.al)

**Person kontakti:** Ergida DERVISHI  
Pozicioni: Shef/ Sektori i Tregimit të Energjisë Elektrike/ Drejtoria e Tregimit të Energjisë/ Departamenti i Administrimit dhe Tregimit të Energjisë  
Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, ndërtesa nr. 88, H. 1, kati 4, Nësia Administrative nr. 7, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 0683732571  
e-mail: [ergida.dervishi@ftl.al](mailto:ergida.dervishi@ftl.al)

**Person kontakti:** Mirela BELBA  
Pozicioni: Shef / Sektori Financiar/ Drejtoria Operacionale/ Departamenti i Tregimit të Energjisë  
Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, ndërtesa nr. 88, H. 1, kati 4, Nësia Administrative nr. 7, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 0694522922  
e-mail: [mirela.belba@ftl.al](mailto:mirela.belba@ftl.al)

**Neni 16**

**Legjislacioni në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**16.1**Kjo kontratë është hartuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me të.

**16.2**Në rast se ndonjë parashikim në këtë Kontratë bie në kundërshtim me ndonjë parashikim në aktet

ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi, atëherë, ky parashikim konsiderohet i pavlefshëm/pazbatueshëm dhe marrëdhënia rregullohet sipas parashikimeve të aktit në fuqi.

**16.3** Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me kontratën ose interpretimin e saj. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje me mirëkuptim, çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë kontratë dhe Aneksat e saj do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Neni 17**

#### **Të ndryshme**

**17.1** Përveçse kur parashikohet ose vendoset ndryshe nga Palët, të gjitha njoftimet, deklaratat ose faturat e dërguara nga një palë, tjetrës duhen dorëzuar zyrtarisht.

**17.2** Çdo amendim ose shtesë në këtë kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët.

### **Neni 18**

#### **Hyrja në fuqi**

**18.1** Kjo kontratë do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga të dy palët.

**18.2** Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) kopje me vlerë të barabartë ligjore në gjuhën shqipe dhe angleze, 3 (tri) kopje për Blerësin dhe 2 (dy) kopje për Shitësin. Nëse ndërmjet kontratës të hartuar në shqip edhe anglisht do të ketë mospërputhje atëherë do të prevalojë varianti i kontratës i hartuar në gjuhën shqipe.

### **PALËT:**

#### **BLERËSI**

Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A

#### **SHITËSI**

Shoqëria ” \_\_\_\_\_ ”

---

**Erina REXHEPI**  
Administrator

---

**Administrator**

## ANEKS NR. 1

### Aneks tip i programit të livrimit dhe shit-blerjes së energjisë elektrike për procedurën përkatëse Nr \_\_\_\_\_

Sot më datë \_\_\_/\_\_\_/202\_, në referim të procedurës së blerjes së energjisë elektrike Nr. Ref \_\_\_\_\_ nënshkruhet ky Aneks Kontrate midis palëve:

**Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A.**, shoqëri aksionere, regjistruar në 30.03.2018 në Regjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81530029T, me seli Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati i IV, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori znj. Erina REXHEPI, në cilësinë e **“Blerësit ose FTL”**

dhe

**Shoqërisë “\_\_\_\_\_” \_\_\_\_\_**, shoqëri \_\_\_\_\_, regjistruar në \_\_\_\_\_ në Regjistrin Tregtar të mbajtur pranë \_\_\_\_\_ me NUIS \_\_\_\_\_, me seli \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, përfaqësuar nga \_\_\_\_\_, në cilësinë e **“Shitësit”**

Sipas ofertës së pranuar nga Blerësi në procedurën e blerjes së energjisë elektrike të datës \_\_\_\_\_, Referenca e procedurës \_\_\_\_\_ specifikohet programi i livrimit si në tabelën më poshtë:

Periudha e livrimit→	(dd - dd/mm/yyyy)				
	ORA↓	Sasia e pranuar ditore [MWh]	Çmimi i pranuar [Euro/MWh]	Total Shuma ditore [Euro]	Sasia e pranuar për periudhën e livrimit [MWh]
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					

13					
14					
15					
16					
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
<b>Total Σ</b>					

**PALËT:**

**BLERËSI**

Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A.

\_\_\_\_\_  
**Erina REXHEPI**  
**Administrator**

**SHITËSI**

Shoqëria ” \_\_\_\_\_ ”

\_\_\_\_\_  
**Administrator**

**ANEKSI NR. 2**

**Aneks tip për sasi të orare të energjisë elektrike të nominuara nga palët.**

Muaji	
Periudha e Livrimit	

Nr. i procedurës	
Tipi i aktivitetit	Shitje
Shoqëria	
Sasia (MWh)	
Pika e livrimit	<b>Rrjeti i Brendshëm</b>

Dita	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Total
dd	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
dd	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
dd	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
dd	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
dd	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
.....	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
.....	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
.....	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
dd	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
dd	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Total periudha</b>																								<b>Σ</b>	

**PALËT:**

**BLERËSI**

Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A.

\_\_\_\_\_  
**Erina REXHEPI**  
**Administrator**

**SHITËSI**

Shoqëria ” \_\_\_\_\_ ”

\_\_\_\_\_  
**Administrator**